

2015

Organizata për Demokraci,
Anti-korruption dhe
Dinjitet –

Çohu!



RREGULLORJA E BORDIT TË ORGANIZATËS ÇOHU!

Organizata për Demokraci, Anti-korruption dhe Dinjitet, ÇOHU!

Rruga: 2 Korriku; Nr.4; Hy.4 Prishtinë, Kosovë

Tel / +381 (0)38 248 506

www.cohu.org

PËRMBAJTJA

Roli dhe Përgjegjësitë e Bordit të Organizatës ÇOHU!.....1

1. Rregullat dhe Procedurat e Bordit.....1
2. Menaxhmenti.....1
3. Vendimet për implementim.....1
4. Vendim-marrja.....2
5. Gjuha e punës.....2
6. Kompensimi.....2
7. Ndryshimet në Statut.....2

Roli dhe Përgjegjësitë e Bordit të Organizatës Çohu!

Bordi i Organizatës Çohu është organ vendim-marrës i cili është përgjegjës për zgjedhjen e drejtorit, përfaqësuesit ligjor, aprovimin e raporteve të auditit, por merret edhe me zhvillimin e politikave të organizatës si dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre.

Bordi vepron në pajtim me fryshtësi dhe politikat që përfshihen në qëllimet e Organizatës ÇOHU!

Përgjegjësitë dhe detyrat e Bordit përcaktohen edhe me Statutin e Organizatës Çohu.

1. Rregullat dhe procedurat e Bordit

Çohu do të mbikëqyret dhe këshillohet nga një Bord, i përbërë nga 3 ose 5 anëtarë të pavarur, dhe me përvojë në çështjet e lidhura me punën e Organizatës Çohu.

Në takimin e tij të parë, Bordi do të zgjedhë Kryetarin njërin nga anëtarët e tij. Bordi ka fuqi të zgjedhë anëtarë të rinj, për të zëvendësuar cilindo nga anëtarët që kanë dhënë dorëheqje ose anëtarësia e të cilëve konsiderohet e përfunduar, duke i korresponduar një periudhe dy herë nga dy vjet. Asnjë anëtar i Bordit nuk guxon ta përdorë organizatën për të promovuar ndonjë aktivitetet të partive politike ose në interes të ndonjë organizate tjeter specifike.

Takimet e rregulla të Bordit mbahen dy (2) herë në vit, por kryetari i Bordit mund të thërrasë takime të Bordit sipas nevojës. Bordi duhet të pajtohet për një orar të përkohshëm të takimeve të paktën një muaj para takimit. Materialet për takim duhet të dërgohen tek të gjithë anëtarët e Bordit të paktën një javë para takimit.

2. Menaxhmenti

Anëtarët (personeli) e organizatës i japin mandatin Bordit në përzgjedhjen e një Drejtori-eshë, dhe përfaqësuesin ligjor. Drejtori i organizatës do të punojë në këshillim me anëtarë e Bordit dhe anëtarët (personelin) e organizatës, dhe njëkohësisht Drejtori Ekzekutiv është edhe sekretar i Bordit pa të drejtë vote.

3. Vendimet për implementim

Bordi, bashkë me drejtorin e organizatës, merr vendime për implementimin e programeve nëpërmjet:

- aprovimit të planit vjetor të punës.
- aprovimit të raporteve financiare dhe narrative mbi aktivitetin vjetor të Organizatës.
- gjetjes së formave alternative të financimit.

- përcaktimit të çeshtjeve tjera me rëndësi.

4. Vendim-marrja

Vendimet e Bordit synohet të merren me konsensus. Në rastet e mospajtimeve ose në rastet specifike të parapara me akte tjera të organizatës, vendimet merren me shumicë të thjeshtë të votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Bordit. Në rast të rezultatit të barabartë të votimit, Kryetari i Bordit do të ketë votën vendimtare. Vendimet e Bordit janë të vlefshme nëse është plotësuar kuorumi i nevojshëm.


5. Gjuha e punës

Gjuha e punës së Bordit është gjuha shqipe, ndërsa sipas nevojës mund të përdoren edhe gjuhët tjera zyrtare që përdoren në Kosove, si ajo serbe ose angleze.

6. Kompensimi

Anëtarët e Bordit të Organizatës Çohu do të kontribuojnë në mënyrë vullnetare për organizatën duke mos u kompensuar gjatë ushtrimit të përgjegjësive në emër të Organizatës Çohu.

Anëtarët e Bordit:

- BESA Luci, B. Duri
- Alban Hashani 
- _____

ORGANIZATA PËR DEMOKRACI ANTI-KORRUPSION DHE DINJITET ÇOHU!

DREJTORI EKZEKUTIV

Lorik Bajrami

Nënshkrimi

Data



01.10.2015